

# Ndikimi i Termocentralit "Kosova e Re" në Tarifat e Energjisë Elektrike\*

INSTITUTI GAP 





# Përmbajtja

## 4 Përmbledhje ekzekutive

## 5 Historik i shkurtër i projektit

6 Pikat kryesore të kontratës për ndërtimin e TC  
"Kosova e Re"

6 Obligimet në periudhën afatshkurtër

## 7 Ndikimi në tarifa

8 Skenari I

8 Skenari II

10 Ndikimi i çmimit të energjisë elektrike në  
ekonomitë familjare

11 Ndikimi tek bizneset

## 14 Përfundim

## 15 Aneks

15 Aneksi 1

17 Ankesi 2

# Përmbledhje ekzekutive

Në fund të vitit 2017, Qeveria e Kosovës nënshkroi kontratën me kompaninë amerikane Contour Global për ndërtimin e një termocentrali të ri me kapacitet bruto 500 MW në vlerë prej 1.3 miliardë euro. Ndonëse thirrja për ofertim ishte hapur sipas Ligjit për prokurimin publik, i cili parasheh një proces tenderues me së paku dy oferta, qeveria nuk e anuloi procesin edhe pse mori vetëm ofertën e kompanisë Contour Global. Me nënshkrimin e kontratës, Qeveria e Kosovës dhe Contour Global (GenCo) janë pajtuar që çmimi i synuar të jetë 80 Euro për MWh.

Ndërtimi i TC "Kosova e Re" është projekt i cili ka ndikim të gjithanshëm në ekonomi, buxhetin e shtetit, shëndet, ambient, zhvendosje të popullsisë, borxhin publik e ndikime tjera. Për të pasqyruar ndikimin e këtij projekti vetëm në çmimin e energjisë elektrike, Instituti GAP në këtë analizë ka ndërtuar dy skenarë. Skenari i parë vlerëson se hyrja në operim e TC "Kosova e Re" në vitin 2023 do të rrisë tarifën e energjisë elektrike për 44%. Kurse sipas skenarit të dytë, i cili përfshin ndërtimin e termocentralit të ri si dhe investimet tjera të planifikuara në fushën e energjisë, tarifën e energjisë elektrike do të pësojnë një ngritje kumulative prej 60.4%.

Përveç dy skenarëve, kjo analizë përmban edhe një pyetësor që Instituti GAP e ka zhvilluar me 84 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në sektorët kryesorë në Kosovë. Me rritjen e tarifave të energjisë elektrike për 60.4% në vitin 2023, vetëm 68% e ndërmarrjeve mbesin në kategorinë me më pak se 4 mijë euro shpenzime për energji elektrike në muaj, nga 80% sa janë tani me tarifën aktuale. Sipas gjetjeve të këtij pyetësori, 31% e ndërmarrjeve konsiderojnë se ngritja e çmimeve të produkteve të tyre do të jetë e paevitueshme, 21% do të shkurtojnë numrin e punëtorëve, dhe rreth 8% do të detyrohen t'i ndërmarrin të dyja veprimet. Sa i përket ekonomive familjare, nga grupet më të rrezikuara nga rritja e çmimit të energjisë elektrike janë familjet të cilat jetojnë nën kufirin e varfërisë. Sipas raportit të vitit 2015 mbi varfërinë në konsum në Kosovë, janë rreth 76,000 familje të cilat jetojnë më me pak se 218 euro në muaj.<sup>1</sup> Prej tyre, janë 50,000 familje të cilat nuk marrin ndonjë ndihmë shtetërore. Nëse bazohemi në të dhënat e prezantuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) rreth shumës së faturuar nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike (KEDS) për amvisëritë, çmimin mesatar aktual të energjisë elektrike dhe numrin e konsumatorëve aktiv, del se fatura mujore e energjisë elektrike së këtyre qytetarëve do të jetë rreth 21% (45 Euro) e të ardhurave mujore të tërë familjes nga 13% (28 euro) sa është tani.

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012 – 2015. Prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2l38Uk0>.

# Historik i shkurtër i projektit

Propozimi fillestar për ndërtimin e termocentralit "Kosova C" u paraqit në vitin 2005, kur me Strategjinë e Energjisë (2005-2015), Qeveria e Kosovës planifikoi ndërtimin e një termocentrali me kapacitet 2,100 MW me një kosto prej 3.5 miliardë euro<sup>2</sup>. Ky propozim doli pas një raporti të Bankës Botërore të publikuar në gusht të vitit 2001 të quajtur Ndhima Teknike e Sektorit të Energjisë në Kosovë (ESTAP).<sup>3</sup>

Në vitin 2006, me vendim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, u themelua Komiteti Drejtues i Projektit. Po atë vit u pranuan propozimet e para dhe u parakualifikuan katër konzorciume të mëdha botërore. Me ndryshimet në qeverisje në fund të vitit 2008, projekti për termocentralin e ri u ndryshua, si për nga emërtimi, i cili filloi të quhej "Kosova e Re", ashtu edhe për nga kapaciteti energjetik. Fillimisht u propozua që termocentrali i ri të ketë kapacitet prej 1,000 MW, për t'u ndryshuar më vonë në 600 MW. Me Strategjinë e Energjisë 2009-2018, parashihej që pjesë e pakos tenderuese bashkë me ndërtimin e termocentralit të ri të jetë edhe termocentrali "Kosova B" dhe mihjet<sup>4</sup>.

Në dhjetor të vitit 2009, Qeveria e Kosovës lëshoi thirrjen e re për shprehje interesi për Zhvillimin e Fushës së Linjimit në Sibovc në Kosovë dhe Kapacitetin e Ri për Prodhimin e energjisë, të cilat përfshinin:

- Ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" (500MW+500MW);
- Zhvillimi i menjëhershëm i fushës së linjimit në Sibovc, dhe
- Pjesëmarrja e sektorit privat në "Kosova B".<sup>5</sup>

Në mars të vitit 2010 u shpallën katër kompanitë e parakualifikuara:

1. **Adani Power / PT Adani Konsorciumi Global** nga India dhe Indonezia;
2. **AES Electric Ltd / Demir Export A.S.** Konsorciumi nga SHBA dhe Turqia;
3. **Park Holding A.S.** nga Turqia;
4. **PPC/ContourGlobal LLP** Konsorciumi nga Greqia dhe Mbretëria e Bashkuar/SHBA.

Nga faza e parakualifikimit të katër kompanive në vitin 2006 e deri në vitin 2011, 10.5 milionë dollarë u shpenzuan nga Banka Botërore për asistencë teknike të projektit, ndërsa 6.5 milion euro nga Qeveria e Kosovës<sup>6</sup>. Në mars 2012, Qeveria e Kosovës dërgoi tek katër kompanitë e parakualifikuara thirrjen finale për ofertim. Nga katër kompanitë e parakualifikuara, më 23 nëntor 2015, u shpall ofertuesi i vetëm – Contour Global.

Përkundër asaj se thirrja për ofertim ishte dërguar duke u bazuar në Ligjin për prokurimin publik, i cili parasheh si të suksesshëm një proces tenderues me së paku dy oferta, qeveria nuk e anuloi procesin edhe pse mori vetëm një ofertë. Fillimisht qeveria u arsyetua se procesi është shpallur dhe menaxhuar duke u bazuar në rregullat e Bankës Botërore, kurse më vonë ky arsyetim u ndryshua duke thënë se është projekt i partneritetit publiko-privat. Pas pranimit të ofertës së vetme, projekti pësoi sërish ndryshim, duke ulur kapacitetin gjenerues nga 600 MW në 500 MW (apo 450 MW neto)<sup>7</sup>.

Kontrata në mes të Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë Contour Global u nënshkrua më 20 dhjetor 2017. Nga shpallja e parë për ndërtimin e termocentralit të ri deri tek nënshkrimi i kontratës kaluan 12 vjet. I tërë procesi është shoqëruar me parregullësi të mëdha, ndryshime të shpeshta, pa transparencë dhe pa konsultim të publikut. Në dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë aprovoi si të bazuar padinë e Institutit GAP kundër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të parashtruar më 2013, për mos transparencë dhe mos lejm të qasjes në dokumentet për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".<sup>8</sup>

2 KOSID. Një histori e shkurtër e një dështimi të madh të politikave të energjisë në Kosovë, 2017. Burimi: <https://bit.ly/2HB2TTw>

3 Banka Botërore. Kosovo - Energy Sector Technical Assistance Project (ERL), 2001. Burimi: <https://bit.ly/2KXS6qh>

4 MZHE. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009 – 2018. Burimi: <https://bit.ly/2HzVJif>

5 KOSID. Një histori e shkurtër e një dështimi të madh të politikave të energjisë në Kosovë, 2017. Burimi: <https://bit.ly/2HB2TTw>

6 Ibid.

7 Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Nënshkruhen Marrëveshjet për termocentralin "Kosova e Re". Burimi: <https://bit.ly/2qx66Hz>

8 Instituti GAP: <https://bit.ly/2ndwMjL>

## Pikat kryesore të kontratës për ndërtimin e TC “Kosova e Re”

Instituti GAP ka analizuar kontratën e nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Contour Global, pikat kryesore e së cilës janë:

- **Kapaciteti gjenerues** – TC “Kosova e Re” do të ketë në vazhdimësi kapacitet gjenerues neto prej 450 MW +/- 20 MW. Kapaciteti gjenerues nuk mund të jetë më i ulët se 430 MW neto apo më i lartë se 470 MW neto. Mirëpo, termocentrali duhet të ketë potencial që të ofrojë 102% të kapacitetit gjenerues maksimal deri në tre raste gjatë vitit<sup>9</sup>;
- **Periudha ndërtuese** – Në vitin 2018, do të fillojë faza e prokurimit për zgjedhjen e ndërtuesit të termocentralit, për t’u finalizuar gjatë vitit 2019 pjesa financiare dhe data e transferit të lokacionit. Më 2019 do të fillojë edhe ndërtimi i termocentralit, i cili do të fillojë prodhimin në vitin 2023<sup>10</sup>;
- **Çmimi i synuar** – Qeveria e Kosovës dhe Contour Global (GenCo) janë pajtuar që çmimi i synuar me shumicë të jetë 80 Euro për MWh. Vlen të theksohet se definimi i këtij çmimi në kontratën komerciale (targeted price) për shkak të terminologjisë së përdorur nuk mund të interpretohet si çmimi tavan (price ceiling);
- **Kriteret teknike** – Termocentrali “Kosova e Re” do të ketë efikasitet neto mbi 40% dhe do të reduktojë në masë të madhe emetimet e pluhurit, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> krahasuar me emetimet aktuale të termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”. Ndërsa, afro 10% e kapacitetit elektrik, rreth 200 MWt, do t’i ofrohet për kogjenerim ngrohtorës Termokos. Termocentrali do të furnizohet me linjit nga fusha e Sibovcit i cili duhet të ketë vlerë kalorifike bruto prej 8,548 GJ/ton<sup>11</sup>.

## Obligimet në periudhën afatshkurtër

Me nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Contour Global, në dhjetor 2017, kanë filluar dhe afatet kohore për kompletimin e tri aktiviteteve:

- Përfundimin e marrëveshjes financiare brenda 12 deri 18 muajve nga qeveria e Kosovës;
- Tenderimi për zgjedhjen e ndërtuesit të termocentralit brenda gjashtë deri tetë muajve nga Contour Global;
- Përgatitja e Strategjisë për Furnizimin me Linjit brenda tre deri gjashtë muajve nga qeveria e Kosovës.

Nga obligimet e renditura më lartë të cilat duhet të përfundojnë përgjatë 2018 dhe 2019, Strategjia për Furnizimin me Linjit është dashur të përfundojë në qershor të këtij viti. Deri më tani, Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka njoftuar nëse është krijuar ndonjë grup punues dhe nuk ka prezantuar ndonjë draft të strategjisë në fjalë.

Ndërsa, përmbyllja e marrëveshjes financiare nuk mund të bëhet pa u finalizuar, ndër të tjera, edhe kushtet e financimit përmes kredisë që do të marrë Contour Global. Në rast se dështon arritja e afatit kohor për kompletimin e këtyre aktiviteteve, konkretisht në rast të shkëputjes së kontratës para fillimit të ndërtimit të termocentralit, atëherë Qeveria e Kosovës duhet të paguajë si ndëshkim ndaj Contour Global mbi 19 milionë euro për shkak të shpenzimeve për kryerjen e studimeve të ndryshme dhe përgatitjen e dokumenteve ligjore.<sup>12</sup> Sa i përket aktivitetit të dytë, në qershor të këtij viti Contour Global ka nisur procesin fillestar të tenderimit për zgjedhjen e ndërtuesit të termocentralit.

9 Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Purchasing Poëer Agreement. Burimi: <https://bit.ly/2qvX0Jj>

10 Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Faktet Kryesore. Burimi: <https://bit.ly/2GZrVOU>

11 Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Lignite Supply Agreement. Burimi: <https://bit.ly/2vdQGBu>

12 Koha Ditore. Ministri Lluka termocentralin “Kosova e Re” e konsideron investim historik. Burimi: <https://bit.ly/2L0JsY8>

# Ndikimi në tarifa

Kontrata për ndërtimin e 'Kosovës së Re' është projekt i cili ka ndikim të gjithanshëm në ekonomi, buxhetin e shtetit, shëndet, ambient, zhvendosje të popullsisë, borxhin publik e ndikime tjera. Vetëm sa i përket borxhit publik, nëse qeveria do të ofrojë garancion shtetëror për projektin "Kosova e Re", borxhi do të arrijë nivelin më të lartë të lejuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ç'rast zvogëlohet dhe mundësia për huazimet për projekte tjera kapitale në vend.<sup>13</sup> Por, në këtë analizë, Instituti GAP ka vlerësuar vetëm ndikimin në tarifa të energjisë elektrike që do të ketë ndërtimi i termocentralit të ri sipas marrëveshjes së nënshkruar dhe investimet tjera në fushën e energjisë. Konkretisht, janë ndërtuar dy skenarë, Skenari I dhe II. Skenari I përfshin vetëm ndikimin e TC "Kosova e Re" në tarifën e energjisë elektrike, kurse Skenari II merr parasysh dhe investimet tjera kapitale në fushën e energjisë.

Pasi që raporti financiar i kontratës ende nuk është finalizuar, kalkulimi i saktë i çmimit të energjisë elektrike me hyrjen në operim të TC "Kosova e Re" është i vështirë. Megjithatë, marrë parasysh disa parametra të ofruar në kontratë, ndryshimet e mundshme në raportin financiar nuk do të kenë ndikim të madh në çmimin e energjisë elektrike.

Hyrja në funksion e termocentralit "Kosova e Re" në vitin 2023 nuk do të ketë ndikim të madh në rritjen e prodhimit dhe punësisë, ngase i njëjti do të zëvendësojë termocentralin "Kosova A". Përveç prodhimit, vlen të theksohet se në këto parashikime, nevojat për import do të vazhdojnë edhe gjatë viteve 2023 dhe 2024 kur pritet të rehabilitohet TC "Kosova B".

Në tarifën aktuale, "Kosova A" dhe "Kosova B" që përbëjnë pjesën më të madhe të tregut, prodhojnë energji me çmim prej 28-30 euro për MWh<sup>14</sup>. Ndërsa pjesa tjetër e çmimit përbëhet nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), hidrocentralet dhe importi. Çmimet e BRE-ve dhe importit janë më të larta se ato të energjisë së prodhuar nga termocentralet, mirëpo për shkak të pjesëmarrjes së vogël të tyre në treg, aktualisht çmimi mesatar me shumicë sillet rreth 35 euro për MWh.<sup>15</sup> Ky çmim pritet të jetë relativisht stabil deri në vitin 2023, kur pas dekomisionimit të "Kosovës A" dhe instalimit të "Kosovës së Re", çmimi që është paguar me shumicë për prodhimin nga "Kosova A" (28-30 euro MWh) do të zëvendësohet me çmimin e synuar të TC "Kosova e Re" prej 80€/MWh.

Megjithatë, çmimi me shumicë nuk është tarifa e fundit që paguajnë konsumatorët. Për të mbërritur tek konsumatorët fundorë, energjia elektrike kalon nëpër Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST), që në Kosovë këtë shërbim e ofron kompania KOSTT. Për këtë, qytetarët aktualisht paguajnë rreth 2.5 - 3€/MWh.<sup>16</sup> Pas kësaj, energjia elektrike kalon nëpër Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) apo transmisionin e ulët që ofrohet nga kompania KEDS të cilën konsumatorët e paguajnë rreth 24€/MWh.<sup>17</sup> Në fund është Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (FPPE) ai që e dërgon energjinë në shtëpitë tona. Këtë shërbim e kryen kompania KESCO për afro 6-8€/MWh.<sup>18</sup>

Në skenarët e paraqitura nga Instituti GAP, çmimet me shumicë ndryshojnë nëpër vite varësisht prej pjesëmarrjes së njësive gjeneruese të energjisë elektrike në treg. Në Skenarin I, çmimet e kompanive që kryejnë shërbimet e bartjes së kësaj energjie janë lënë të njëjta nëpër vite. Kurse në modelin i cili bazohet në Skenarin II, çmimet e kompanive në fjalë kanë ndryshuar bazuar në ndikimin e investimeve në fushën e energjisë.

14 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë). Raport Konsultativ: Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike. Burimi: <https://bit.ly/2HAsBaE>. Dhe, të dhënat e pranuar përmes kërkesës drejtuar ZRRë, qershor 2018.

15 Të dhënat e pranuar përmes kërkesës drejtuar ZRRë, qershor 2018.

16 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë). Raport Konsultativ: Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike. Burimi: <https://bit.ly/2HAsBaE>

17 Ibid.

18 Ibid.

13 Ministria e Financave. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021. Burimi: <https://bit.ly/2zq5VJM>

## Skenari I

Modeli i paraqitjes së rritjes së çmimeve të energjisë elektrike sipas Skenarit I për vitet 2017 – 2026 është tejet konservativ ngase nuk merr për bazë investimet tjera që janë planifikuar të bëhen në sektorin e energjisë, siç janë dekomisionimi i TC "Kosova A", investimet në TC "Kosova B" prej afër 300 milionë eurove dhe investimeve tjera në mihje të cilat detyrimisht do të reflektohen në tarifa.

Prandaj, uljet eventuale të çmimit të synuar prej 80€/MWh nuk do të rezultojnë në tarifa më të ulëta sesa ato që janë paraqitur në këtë analizë. Për më tepër, kjo analizë merr për bazë edhe parashikimin e konsumit dhe prodhimit të energjisë elektrike e cila është siguruar nga Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026 (skenarin bazë dhe atë të lartë)<sup>19</sup>.

Në figurën 1, shihet se çmimi me pakicë do të ketë një rritje të lehtë deri në ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re". Më pas, çmimi i cili paguhet nga konsumatorët fundorë do të pësojë një ngritje kumulative prej 44% në krahasim me çmimin aktual.

## Skenari II

Ndërsa, modeli i paraqitjes së rritjes së çmimeve të energjisë elektrike sipas Skenarit II të përgatitur nga Instituti GAP për periudhën 2017 – 2026 përfshin:

- Investimet në hapjen e minierës së re. Sipas MZHE-së, rreth 350 milionë euro planifikohen të investohen në hapjen e minierës së re.<sup>20</sup> Ndikimi i këtij investimi në rritjen e tarifës së KEK-ut është llogaritur duke marrë parasysh jetëgjatësinë e asetëve të saj të përcaktuar nga ZRrE. Mirëpo është konsideruar dhe ndikimi pozitiv që do të ketë hapja e minierës në rritjen e efijencës së punës, konkretisht në uljen e shpenzimeve operative dhe njëherit të hyrave maksimale të lejuara, dhe rritjen e performancës së gjeneratorëve, duke neutralizuar kështu në një masë rritjen në tarifën e KEK-ut. Andaj, ndikimi mesatar vjetor në tarifën e KEK nga ky investim pritet të jetë rreth 6%;
- Rehabilitimin e TC "Kosova B" që pritet të kushtojë rreth 300 milionë euro.<sup>21</sup> Fillimi i investimeve pritet të ndodhë me hyrjen në punë të TC "Kosova e Re", në mënyrë që të ketë prodhim të brendshëm të njëjtë në vazhdimësi. Kjo vërehet edhe në skenarin e prodhimit të energjisë elektrike të përgatitur nga MZHE, konkretisht në Strategjinë e Energjisë 2017-2026, ku kapaciteti prodhues i TC "Kosova B" bie

në vitin 2023.<sup>22</sup> Ndikimi i këtij investimi në tarifën e KEK-ut, prej mesatarisht 4%, është përfshirë në skenarin tonë nga viti 2023 e tutje;

- Investimet kapitale të realizuara në vazhdimësi nga KEDS sipas kontratës së shitblerjes. Deri më tani, KEDS ka realizuar rreth 100 nga 300 milionë euro investime sa parashihen në kontratë për periudhën 15 vjeçare.<sup>23</sup> Investimet e realizuara nga KEDS kanë pasur ndikim gjerë më tani në rritjen e vlerës së zhvlerësimit dhe kthimit në kapital rreth 2-3% në baza vjetore, që është reflektuar dhe në rritjen e tarifave vjetore të KEDS. Të njëjtën normë të rritjes në tarifa e kemi përfshirë dhe në modelin tonë për vitet 2017-2023;
- Koston e humbjes së lejuar të KEDS nga ZRrE e cila do të ketë ndikim të madh në rritjen e tarifës së KEDS në vitin 2023. Meqë, sasia e humbjeve të lejuara të KEDS llogaritet duke përdorur çmimin e energjisë elektrike me shumicë, dhe që i njëjti do të rritet për rreth 73% në vitin 2023, atëherë ndikimi në tarifën e KEDS i këtij komponenti do të jetë i madh. Gjithsesi, efekt neutralizues në këtë rritje mund të ketë ulja e caktuar të humbjeve mirëpo konsumi total vjetor në Kosovë është duke u rritur vazhdimisht<sup>24</sup>;
- Tarifat nxitëse të cilat supozohet të ndryshojnë sipas normës së inflacionit në Eurozonë<sup>25</sup> e që pritet të jetë rreth 0.5 deri 2% në vitet në vijim;
- Ndryshimin që mund të vjen nga tarifa e KESCO e cila merr një përqindje prej 0.3% për shitjen e energjisë elektrike me pakicë;
- Për më tepër, kjo analizë merr për bazë edhe parashikimin e konsumit dhe prodhimit të energjisë elektrike e cila është siguruar nga Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026 (skenari i lartë)<sup>26</sup>.

Siç vërehet dhe në figurën 2, ndikimi në tarifa në vitin 2023 nga ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" dhe investimet tjera në fushën e energjisë do të jetë rreth **60.4%** më i lartë krahasuar me çmimin aktual. Konkretisht, nga rreth 68 euro për MWh sa paguajnë konsumatorët fundorë tani, në 2023 ky çmim pritet të arrijë në 116 euro për MWh.

<sup>22</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017 – 2026. Burimi: <https://bit.ly/2lKefDH>.

<sup>23</sup> Kuvendi i Kosovës, Procesverbali i mbledhjes së komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri. Burimi: <https://bit.ly/2KoQA14>. Dhe, KEDS. Energy 2017. Burimi: <https://bit.ly/2yZp3y7>.

<sup>24</sup> Shih trendin rritës në skenarët rreth konsumit të energjisë në Strategjinë e energjisë e republikës së Kosovës 2017 – 2026.

<sup>25</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). Vendim V\_810\_2016. Burimi: <https://bit.ly/2KrXpPB>.

<sup>26</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Pavarësi energjetike për Kosovën. Burimi: <https://bit.ly/2lFaph9>. Dhe, Udhëzimi administrativ (MZHE) nr. 05/2017 caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Burimi: <https://bit.ly/2lMdaCh>.

<sup>19</sup> Ibid.


<sup>20</sup> Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Pavarësi energjetike për Kosovën. Burimi: <https://bit.ly/2lFaph9>.

<sup>21</sup> Ibid.




**FIGURA 1:** Çmimi i energjisë elektrike me pakicë për vitet 2017-2026 sipas Skenarit I

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE



**FIGURA 2:** Çmimet e energjisë elektrike me pakicë për vitet 2017-2026 sipas Skenarit II

Burimi: Insituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE



## Ndikimi i çmimit të energjisë elektrike në ekonomitë familjare

Aktualisht janë rreth 515 mijë konsumatorë të energjisë elektrike në Kosovë, ku rreth 437 mijë (84%) prej tyre janë konsumatorë shtëpiak (amvisëri).<sup>27</sup> Bazuar në konsumin vjetor të amvisërive, rreth 2,214 GWh, dhe çmimin mesatar të shitjes së energjisë elektrike në 2017, 6.52 €cent/kWh (përfshirë TVSH), del se konsumi mujor (mesatar) i energjisë elektrike nga një amvisëri në Kosovë është rreth 422 kWh.<sup>28</sup> Në vlerë monetare, fatura mujore mesatare e një familjeje në Kosovë është rreth 28 Euro. Siç vërehet edhe në tabelën 1, ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë elektrike në buxhetin e familjes do të jetë më i theksuar sidomos për familjet me të hyra mujore deri në 628 Euro.

27 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE). Ofrimi i shërbimeve për konsumatorë nga KEDS dhe KESCO për periudhën janar 2015 - qershor 2016. Burimi: <https://bit.ly/2IUbgsl>. Dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE). Raporti vjetor 2017.

28 Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti vjetor 2017.

Nga grupet më të rrezikuara nga rritja e çmimit të energjisë elektrike janë familjet të cilat jetojnë nën kufirin e varfërisë. Sipas raportit të vitit 2015 mbi varfërinë në konsum në Kosovë, janë rreth 76,000 familje të cilat jetojnë më me pak se 218 euro në muaj.<sup>29</sup> Prej tyre, janë 50,000 familje të cilat nuk marrin ndonjë ndihmë shtetërore. Nëse bazohemi në të dhënat e prezantuara nga ZrRE rreth shumës së faturuar nga KEDS për amvisëritë, çmimin mesatar aktual të energjisë elektrike dhe numrin e konsumatorëve aktiv, del se fatura mujore e energjisë elektrike së këtyre qytetarëve do të jetë rreth 21% (45 Euro) e të ardhurave mujore të tërë familjes. Kësisoj, shumë nga këto familje do të shtyhen në varfëri të skajshme, duke u përballur me kushte të rënduara për shkak të uljes së konsumit të energjisë apo zëvendësimit të saj me produktet tjera bazike. Për 26,000 familjet të cilat janë pjesë e Skemës së Ndihmës Sociale (SNS), qeveria aktualisht ndan rreth 4.5 milionë euro për t'ua mbuluar shpenzimet e energjisë elektrike.<sup>30</sup> Rritja e çmimit në këtë rast do të ndikojë negativisht në buxhetin e shtetit. Konkretisht, për të subvencionuar sasinë e njëjtë të energjisë elektrike si në 2018, në vitin 2023 qeveria do të duhet të ndajë rreth 7.2 milionë euro.

**TABELA 1:** Fatura mujore e energjisë elektrike si përqindje e të hyrave mujore para dhe pas ndërtimit të TC "Kosova e Re"

Të hyrat mujore të familjes	Konsumi mujor i amvisërive	Çmimi mesatar energjisë elektrike për amvisëritë (duke përfshirë TVSH)	Fatura mujore e energjisë elektrike si përqindje e të hyrave mujore aktualisht	Fatura mujore e energjisë elektrike si përqindje e të hyrave mujore pas ngritjes së çmimit prej <b>60.4%</b>
<b>218 €</b>	422 kWh	6.52 €cent/kWh	13% (28 euro)	<b>21%</b> (45 euro)
<b>500 €</b>	537 kWh	6.52 €cent/kWh	7% (35 euro)	<b>11%</b> (56 euro)
<b>628 €</b>	614 kWh	6.52 €cent/kWh	6% (40 euro)	<b>10%</b> (64 euro)
<b>1000 €</b>	690 kWh	6.52 €cent/kWh	4.5% (45 euro)	<b>7%</b> (72 euro)

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ZrRE

29 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012 – 2015. Prill 2017. Burimi: <http://bit.ly/2l38Uk0>.

30 Ministria e Financave. Buxheti i Republikës së Kosovës 2018. Burimi: <https://bit.ly/2Hp74E2>


## Ndikimi tek bizneset

Për bizneset në Kosovë, sidomos ato prodhuese, kostoja e energjisë elektrike mbetet nga faktorët kryesorë që ndikojnë në operimin e tyre. Për të pasqyruar këtë ndikim, Instituti GAP ka realizuar një anketë me biznese të sektorëve kryesorë në Kosovë si prodhimi, përpunimi, shërbimet, tregtia, e të tjera. Në këtë mostër janë përfshirë 84 ndërmarrje të vogla dhe të mesme me shtrirje në pothuajse tërë Kosovën.

Më shumë se 14% e ndërmarrjeve të intervistuar deklaruan se energjia elektrike përbën shpenzimin më të madh mujor të biznesit, ndërsa 75% deklaruan se kosto primare është lënda e parë e pasuar nga energjia elektrike. Së bashku, rreth 90% e bizneseve deklaruan se energjia elektrike dhe lënda e parë janë dy shpenzimet kryesore për ndërmarrjet e tyre duke lënë pas pagat e punëtorëve dhe shpenzimet e tjera operative.


Rreth 80% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të intervistuar paguajnë fatura të energjisë elektrike mesatarisht më pak se 4 mijë euro në muaj. Ndërsa me rritjen e tarifave për 60.4% si pasojë e TC "Kosova e Re" dhe investimeve tjera në fushën e energjisë, vetëm 68% mbesin në kategorinë e parë me më pak se 4 mijë euro shpenzime për energji elektrike. Figura 3 paraqet përqindjen e bizneseve që paguajnë shumën të ndryshme të energjisë elektrike para dhe pas ngritjes së tarifave. Aktualisht, një kompani në fushën e prodhimit të materialeve termoizoluese paguan mesatarisht 33 mijë euro në muaj energji elektrike. Me ngritjen e tarifave për 60.4%, e njëjta do të detyrohet të paguajë rreth 53 mijë euro.

**FIGURA 3:** Shpenzimet mesatare mujore të bizneseve në faturat e energjisë elektrike



Me ngritjen e çmimit të energjisë elektrike, bizneset e intervistuar deklaruan se operimi i tyre do të jetë tejet i vështirë. Në Figurën 4 janë paraqitur vendimet që bizneset konsiderojnë se do t'i ndërmarrin menjëherë pas ngritjes së tarifave. Në këtë figurë shohim se 31% e bizneseve deklaruan se ngritja e çmimeve të produkteve do të jetë e paevitueshme, 21% do të shkurtojnë numrin e punëtorëve, dhe rreth 8% do të detyrohen t'i ndërmarrin të dyja veprimet.

**FIGURA 4:** Vendimet e bizneseve pas ngritjes së çmimit të energjisë elektrike për 60.4%




Nga investitorët e mëdhenj të huaj në Kosovë, njëherit konsumatorë industrial, Ferronikeli dhe Sharrcemi, varen në masë të madhe në përdorimin e energjisë elektrike. Konkretisht, ato konsumojnë së bashku mbi 12% të energjisë së prodhuar në vend dhe furnizohen direkt nga rrjeti i transmisionit.<sup>31</sup> Çmimi me të cilin janë furnizuar këto dy ndërmarrje ndër vite nuk ka kaluar vlerën prej 50 Euro për MWh, vlerë kjo me e ulët se ajo për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek konsumatorët dhe bizneset e vogla. Ndërsa, në rast të ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", vetëm ngarkesa për kapacitet, 60 Euro për MWh, do të jetë më e lartë se tërë çmimi i furnizimit të Sharrcemit dhe Ferronikelit aktualisht. Ndërsa, çmimi që do të paguajnë këto ndërmarrje nga viti 2023 do të jetë të paktën 80 Euro për MWh. Në këto kushte, thuajse do të jetë i pamundur vazhdimi i operimit i këtyre dy konsumatorëve industrial. Marrë parasysh se vetëm Ferronikeli dhe Sharrcemi punësojnë së bashku mbi 1,000 punëtorë, direkt dhe tërthorazi, ikja e tyre nga tregu do të ndikonte në uljen e mirëqenies së shumë qytetarëve në Kosovë.

31 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE). Raport Konsultativ: Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike. Burimi: <https://bit.ly/2HAsBaE>

Ndërsa, ndërmarrjet prodhuese do të ballafaqohen me ngecje në zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjes dhe do të jenë më pak konkurruese. Për të neutralizuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike ato duhet të reduktojnë shpenzimet tjera, përfshirë numrin e punëtorëve, ose të rrisin çmimin e shitjes. Në të dy rastet ato do të kenë të vështirë të përballojnë konkurrencën nga produktet e njëjta prej vendeve të huaja në të cilat nuk parashihen rritje të tilla të çmimit të energjisë elektrike.

Në anën tjetër, në rast të bartjes së kostos së rritjes së çmimit të energjisë elektrike në çmimin e produkteve të tyre, këto ndërmarrje do të përballen me konkurrencë të fortë nga produktet e vendeve fqinje. Ndërmarrjet në këto vende edhe ashtu kanë avancuar më shumë në pjesën e prodhimit për shkak të përvojës së fituar ndër vite. Siç vërehet nga Figura 5, aktualisht shtetet si Maqedonia, Bosnja, Serbia, dhe vendet tjera, kanë çmime më të favorshme të energjisë elektrike për industrinë. Andaj, përveç përparësisë në treg për shkak të eksperiencës së ndërmarrjeve që i prodhojnë ato dhe avancimit në metoda të prodhimit, produktet e vendeve të huaja do të kenë përparësi edhe në aspektin e inputeve më të lira të prodhimit. Kështu që, me rritjen e çmimit të energjisë elektrike në vitin 2023 për minimum 44%, Kosova rrezikon të bëhet vendi më jo-tërheqës në rajon në këtë aspekt për investitorët e huaj.

**FIGURA 5:** Çmimet mesatare të konsumatorëve të mëdhenj industrial (pa TVSH), janar-qershor 2017



Burimi: Insituti GAP, bazuar në të dhënat e Eurostat

Në vitin 2023, siç vërehet në Figurën 5, çmimi i energjisë elektrike për industrinë në Kosovë do të rritet në 12.8 cent për kWh, që është rreth 6.5 centë më i lartë krahasuar me çmimet në Maqedoni dhe Serbi.

# Përfundim

Kosova përballet me probleme të mëdha në sektorin energjetik, në një rënë anë nga vjetërsimi i kapaciteteve aktuale gjeneruese, dhe në anën tjetër nga mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të energjisë elektrike. Furnizimi jo i mjaftueshëm me energji elektrike është një ndër problemet më të mëdha të bizneseve në Kosovë.

Institucioneve të Kosovës iu deshtën plot 12 vite nga shpallja e thirrjes së parë për ndërtimin e termocentralit të ri e deri tek nënshkrimi i kontratës për ndërtim. Por, kushtet e kontratës së nënshkruar në dhjetor të 2017 në mes të Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë Contour Global janë tepër të pafavorshme për ekonominë e vendit. Bazuar në të gjeturat e Institutit GAP, termocentrali i ri do të rëndojë tejmasë buxhetin e ekonomive familjare, do të rrisë koston operative të bizneseve dhe shkallën e papunësisë, si dhe do të ketë ndikim negativ në buxhetin e Kosovës.

Kjo analizë e Institutit GAP nuk ka analizuar kontratën në tërësi, por është fokusuar vetëm në ndikimin që do të ketë ndërtimi i TC "Kosova e Re" në tarifat e energjisë elektrike. Një analizë e këtillë do të duhej të ndërmerrej dhe publikohej nga ZRrE ende pa u nënshkruar kontrata në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Contour Global.

Gjithashtu, duke marrë parasysh se kontrata për TC "Kosova e Re" do të ketë edhe implikime buxhetore, duke filluar nga pagesat direkte nga buxheti për faturat e familjeve me gjendje të rënduar sociale, investimet që pritet të ndodhin në mihje, themelimi i ndërmarrjeve të reja publike për blerjen e energjisë nga "Kosova e Re" dhe menaxhimin e mihjeve, e të tjera, Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga Ministria e Financave një Vlerësim të Ndikimit Financiar për kontratën e 'Kosovës së Re'. Po ashtu, Ministria e Financave duhet të vlerësojë ndikimin e TC "Kosova e Re" në borxhin publik, pasi që këtë nuk e ka bërë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2020, dhe si rrjedhojë, të prezentojë rreziqet për qasjen në financa për projektet tjera kapitale.

Në formën e tanishme, marrëveshja për ndërtimin e TC "Kosova e Re" mund të sjellë më shumë pasojë negative për ekonominë e vendit se sa ndikim pozitiv.

**TABELA 2:** Parashikimi i prodhimit, çmimit, dhe kostos së energjisë elektrike GWh me shumicë bazuar në Skenarin I

Çmimet e EE janë marrë nga raporti konsultativ: Shqyrtimi i 10 i tarifave të energjisë elektrike ero-ks.org

Prodhimi i energjisë elektrike		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
	TC Kosova A	GWh	1982	1800	1800	1800	1800	1800	0	0	0	0
	TC Kosova B	GWh	3563	3200	3200	3200	3200	3200	2000	1600	3400	3400
	TC Kosova e Re	GWh	0	0	0	0	0	0	3370	3370	3370	3370
	<b>Totali nga termocentralet</b>	<b>GWh</b>	<b>5545</b>	<b>5000</b>	<b>5000</b>	<b>5000</b>	<b>5000</b>	<b>5000</b>	<b>5370</b>	<b>4970</b>	<b>6770</b>	<b>6770</b>
	HC Ujmani	GWh	95	92	92	92	92	92	92	92	92	92
	HC tjera (Lumbardhi, Dikance, Burimi, Radavci)	GWh	193	309	336	357	366	366	366	366	396	423
	<b>Totali nga hidrocentralet</b>	<b>GWh</b>	<b>288</b>	<b>401</b>	<b>428</b>	<b>449</b>	<b>458</b>	<b>458</b>	<b>458</b>	<b>458</b>	<b>488</b>	<b>515</b>
	Biomasa	GWh	0	0	0	30	30	38	53	53	68	68
	ERA	GWh	2	61	109	123	193	193	210	210	228	268
	Solare	GWh	1	8	8	10	10	12	12	14	14	16
	<b>Totali nga burimet e ripërtrishme</b>	<b>GWh</b>	<b>3</b>	<b>69</b>	<b>117</b>	<b>163</b>	<b>233</b>	<b>243</b>	<b>275</b>	<b>277</b>	<b>310</b>	<b>352</b>
	<b>Totali i neto prodhimit</b>		<b>5836</b>	<b>5470</b>	<b>5545</b>	<b>5612</b>	<b>5691</b>	<b>5701</b>	<b>6103</b>	<b>5705</b>	<b>7568</b>	<b>7637</b>
	Importi	GWh	763	763	789	853	870	971	524	1036	100	100
	Exporti	GWh	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350
	<b>Energjia elektrike neto e disponueshme</b>		<b>6249</b>	<b>5883</b>	<b>5984</b>	<b>6115</b>	<b>6211</b>	<b>6322</b>	<b>6277</b>	<b>6391</b>	<b>7318</b>	<b>7387</b>

Çmimi i blerjes së energjisë		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
	TC Kosova A	€/MWh	28	28	28	29	29	29	0	0	0	0
	TC Kosova B	€/MWh	28	28	28	29	29	29	29	29	29	29
	TC Kosova e Re	€/MWh	0	0	0	0	0	0	80	80	80	80
	HPP Ujmani	€/MWh	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5
	Existing (Lumbardhi, Dikance, Burimi, Radavci)	€/MWh	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8	43.8
	Biomasa	€/MWh	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3	71.3
	ERA	€/MWh	85	85	85	85	85	85	85	85	85	85
	Solare	€/MWh	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4	136.4
	Importi	€/MWh	55	55	55	55	55	55	55	55	55	55
	Exporti	€/MWh	37	37	37	37	37	37	37	37	37	37

Kostoja		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
	TC Kosova A	€'000	€ 55,496	€ 50,400	€ 50,400	€ 52,200	€ 52,200	€ 52,200	€ -	€ -	€ -	€ -
	TC Kosova B	€'000	€ 99,764	€ 89,600	€ 89,600	€ 92,800	€ 92,800	€ 92,800	€ 58,000	€ 46,400	€ 98,600	€ 98,600
	TC Kosova e Re	€'000	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ 69,600	€ 269,600	€ 269,600	€ 269,600
	HPP Ujmani	€'000	€ 2,613	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530
	Existing (Lumbardhi, Dikance, Burimi, Radavci)	€'000	€ 8,453	€ 13,534	€ 14,717	€ 15,637	€ 16,031	€ 16,031	€ 16,031	€ 16,031	€ 17,345	€ 18,527
	Biomasa	€'000	€ -	€ -	€ -	€ 2,139	€ 2,139	€ 2,709	€ 3,779	€ 3,779	€ 4,848	€ 4,848
	ERA	€'000	€ 170	€ 5,185	€ 9,265	€ 10,455	€ 16,405	€ 16,405	€ 17,850	€ 17,850	€ 19,380	€ 22,780
	Solare	€'000	€ 136	€ 1,091	€ 1,091	€ 1,364	€ 1,364	€ 1,637	€ 1,637	€ 1,910	€ 1,910	€ 2,182
	Importi	€'000	€ 41,965	€ 41,965	€ 43,395	€ 46,915	€ 47,850	€ 53,405	€ 28,820	€ 56,980	€ 5,500	€ 5,500
	Exporti	€'001	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)	€ (12,950)
	<b>Total</b>	<b>€'002</b>	<b>€ 195,647</b>	<b>€ 191,355</b>	<b>€ 198,048</b>	<b>€ 211,090</b>	<b>€ 218,369</b>	<b>€ 224,767</b>	<b>€ 385,297</b>	<b>€ 402,129</b>	<b>€ 406,763</b>	<b>€ 411,618</b>

Çmimi mesatar me shumicë		€	31.3	32.5	33.1	34.5	35.2	35.6	61.4	62.9	55.6	55.7

Burimi: Institutu GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE dhe KOSTT

**TABELA 3:** Parashikimi i prodhimit, çmimit, dhe kostos së energjisë elektrike GWh me shumicë bazuar në Skenarin II

Çmimet e EE janë marrë nga raporti konsultativ: Shqyrtimi i 10 i tarifave të energjisë elektrike ero-ks.org

Prodhimi i energjisë elektrike		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
TC	TC Kosova A	GWh	1800	1800	1800	1800	1800	1800	0	0	0	0
	TC Kosova B	GWh	3200	3200	3200	3200	3200	3200	2000	1600	3400	3400
	TC Kosova e Re	GWh	0	0	0	0	0	0	3370	3370	3370	3370
Totali nga termocentralet		GWh	5000	5000	5000	5000	5000	5000	5370	4970	6770	6770
Hidro	HC Ujmani	GWh	95	92	92	92	92	92	92	92	92	92
	HC tjera (Lumbardhi, Dikance, Burimi,	GWh	193	309	336	357	366	366	366	366	396	423
	Totali nga hidrocentralet	GWh	288	401	428	449	458	458	458	458	488	515
BRE	Biomasa	GWh	60	75	90	150	152	153	155	156	158	159
	ERA	GWh	123	231	260	302	305	308	311	314	318	321
	Solare	GWh	14	16	19	62	62	63	64	64	65	65
Totali nga burimet e ripërtishme		GWh	197.4	322.8	368.4	513.9	519.039	524.229	529.472	534.766	540.114	545.515
Totali I neto prodhimit			5485	5724	5796	5963	5977	5982	6357	5963	7798	7831
Totali I neto prodhimit	Importi	GWh	763	763	789	853	870	971	524	1036	100	100
	Exporti	GWh	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350	-350
Energjia elektrike neto e disponueshme			5898	6137	6235	6466	6497	6603	6531	6649	7548	7581

Çmimi i blerjes së energjisë		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
TC	TC Kosova A	€/MWh	30.4	32.224	34.15744	36.207	38.3793	40.682	0	0	0	0
	TC Kosova B	€/MWh	30.4	32.224	34.15744	36.207	38.3793	40.682	44.750	49.2253	54.148	59.563
	TC Kosova e Re	€/MWh	0	0	0	0	0	0	80	80	80	80
Hidro	HPP Ujmani	€/MWh	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5	27.5
	Existing (Lumbardhi, Dikance, Burimi,	€/MWh	43.8	44.238	44.68038	45.127	45.578	46.034	46.495	46.959	47.429	47.903
BRE	Biomasa	€/MWh	71.3	72.013	72.73313	73.460	74.195	74.937	75.686	76.443	77.208	77.979
	ERA	€/MWh	85	85.85	86	86.86	87	87.87	88	88.88	89	89.89
	Solare	€/MWh	136.4	137.764	137.4	138.774	138.4	139.784	139.4	140.794	140.4	141.804
	Importi	€/MWh	55	55	55	55	55	55	55	55	55	55
Exporti		€/MWh	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8	37.8


Kostoja		Njesia\Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
TC	TC Kosova A	€'000	€ 54,720	€ 58,003	€ 61,483	€ 65,172	€ 69,083	€ 73,228	€ -	€ -	€ -	€ -
	TC Kosova B	€'000	€ 97,280	€ 103,117	€ 109,304	€ 115,862	€ 122,814	€ 130,183	€ 89,501	€ 78,760	€ 184,103	€ 202,513
	TC Kosova e Re	€'000	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ 269,600	€ 269,600	€ 269,600	€ 269,600
Hidro	HPP Ujmani	€'000	€ 2,613	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530	€ 2,530
	Existing (Lumbardhi, Dikance, Burimi, Radavci)	€'000	€ 8,453	€ 13,670	€ 15,013	€ 16,110	€ 16,682	€ 16,849	€ 17,017	€ 17,187	€ 18,782	€ 20,263
BRE	Biomasa	€'000	€ 4,278	€ 5,401	€ 6,546	€ 11,019	€ 11,241	€ 11,466	€ 11,697	€ 11,932	€ 12,172	€ 12,417
	ERA	€'000	€ 10,455	€ 19,866	€ 22,351	€ 26,249	€ 26,554	€ 27,088	€ 27,399	€ 27,950	€ 28,268	€ 28,836
	Solare	€'000	€ 1,964	€ 2,259	€ 2,542	€ 8,562	€ 8,625	€ 8,798	€ 8,862	€ 9,040	€ 9,105	€ 9,288
	Importi	€'000	€ 41,965	€ 41,965	€ 43,395	€ 46,915	€ 47,850	€ 53,405	€ 28,820	€ 56,980	€ 5,500	€ 5,500
Exporti		€'001	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)	€ (13,230)
Total		€'002	€ 208,498	€ 233,581	€ 249,934	€ 279,190	€ 292,148	€ 310,316	€ 442,196	€ 460,750	€ 516,829	€ 537,716
Çmimi mesatar me shumicë		€	35.3	38.1	40.1	43.2	45.0	47.0	67.7	69.3	68.5	70.9

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE, MZHE dhe Udhëzimit administrativ (MZHE) nr. 05/2017




## Ankesi 2

**FIGURA 6:** Prodhimi i energjisë elektrike GWh në bazë të Skenarit I



Burimi:KOSTT

**FIGURA 7:** Çmimet e energjisë elektrike me shumicë për vitet 2017-2026 sipas Skenarit I



Burimi:Insituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE


—○— Çmimi me shumicë —○— Përqindja e rritjes kumulative

**TABELA 4:** Çmimi mesatar me pakicë sipas Skenarit I

		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
<b>Çmimi mesatar me shumicë</b>	€/MWh	30.00	31.20	31.80	32.50	33.10	33.60	60.60	62.30	54.40	54.60
<b>OST (KOSTT)</b>	€/MWh	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
<b>OSSH (KEDS)</b>	€/MWh	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00
<b>FPEE(KESCO etj.)</b>	€/MWh	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00	8.00
<b>Çmimi mesatar me pakicë</b>	€/MWh	65.00	66.20	66.80	67.50	68.10	68.60	95.60	97.30	89.40	89.60


Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE

**FIGURA 8:** Prodhimi i energjisë elektrike GWh në bazë të Skenarit II



Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e MZHE dhe Udhëzimit administrativ (MZHE) nr. 05/2017

**FIGURA 9:** Çmimet e energjisë elektrike me shumicë për vitet 2017-2026 sipas Skenarit II




Burimi: Insituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE

**TABELA 5:** Çmimi mesatar me pakicë sipas Skenarit II

		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
<b>Çmimi mesatar me shumicë</b>	€/MWh	35.35	38.06	40.08	43.18	44.97	46.99	67.70	69.30	68.47	70.93
<b>OST (KOSTT)</b>	€/MWh	2.50	2.51	2.52	2.53	2.54	2.55	2.56	2.57	2.58	2.59
<b>OshT (KEDS)</b>	€/MWh	23.50	24.02	24.55	25.09	25.64	26.20	39.30	40.17	40.97	41.79
<b>FPEE (KESCO etj.)</b>	€/MWh	7.00	7.01	7.02	7.03	7.04	7.05	7.06	7.07	7.08	7.09
<b>Çmimi mesatar me pakicë</b>	€/MWh	68.35	71.60	74.17	77.82	80.18	82.80	116.62	119.11	119.10	122.40

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ZRrE

Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

